

Legjionaret/ Etrit Berisha gol trepikesh per Kalmarin

nga AlbaniaSoccer
E diel, 01 Shtator 2013 19:04



Etrit Berisha ka shenuar nje gol me vlera trepikeshe. Portieri shqiptar I ka dhene fitoren Kalmarit ne ndeshjen ndaj Halmstadit. Takimi eshte mbyllur me rezultatin 1-0 dhe te vetmin gol e ka shenuar Etriti nga pika e bardhe e penalltise. Per Berishen ky pritet te jete takimi I fundit ne Suedi pasi tani pret te transferohet ne Itali tek skuadra e Lazios. Menjehere pas ndeshjes, portieri ka marre rrugen per te ardhur ne Shqiperi ku do te grumbullohet me kombetaren e Shqiperise.